

**Lindita Arapi***Shqipëri / Gjermani***Arian Leka***Shqipëri***Luljeta Lleshanaku***Shqipëri***Fatos Lubonja***Shqipëri***Khaled al Khamissi***Egjipt***Ilma Rakusa***Zvicër***Hans-Ulrich Treichel***Gjermani***Agron Tufa***Shqipëri*

Hyrja është e lirë.

Vendndodhja: Teatri Kombëtar i Komedisë

*Rruga Sermedin Said Toptani.*

Allianz  
Kulturstiftung  



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E KULTURËS

*Një projekt i fondacionit Allianz Kulturstiftung  
në bashkëpunim me Literarischen Colloquium Berlin  
si dhe Ministrinë e Kulturës së Shqipërisë.*

# DETI I BARDHË

Letërsitë përreth

Mesdheut

4. / 5. Tetor 2013

**Lindita Arapi***Shqipëri / Gjermani***Arian Leka***Shqipëri***Luljeta Lleshanaku***Shqipëri***Fatos Lubonja***Shqipëri***Khaled al Khamissi***Egjipt***Ilma Rakusa***Zvicër***Hans-Ulrich Treichel***Gjermani***Agron Tufa***Shqipëri*

<b>DETI I BARDHË</b>	<b>PROGRAMI</b>	<b>KURZBIOGRAFIEN DER AUTOREN</b>
<span></span>	<span></span>	<span></span>
Nën moton »Europa si hapësirë kujtese«, në datat 4. dhe 5. Tetor 2013, poetë, shkrimtarë dhe publicistë nga Shqipëria, Gjermania, Zvicra, Egjipti etj. ftohen të diskutojnë me njëritjetrin mbi gjëra që i bashkojnë dhe i ndajnë në trashëgiminë e përbashkët transnacionale.	<b>E PREMTE Ǆ 4. TETOR 2013</b>	<b>LINDITA ARAPI</b> (Gjermani Ǆ Shqipëri) Lindita Arapi, lindur në 1972 në Lushnjë, është shkrimtare dhe gazetare shqiptare. Autorja me vendbanimin në Gjermani ka botuar prej fundit të 90-ve disa përmbledhje me poezi, ndërsa në vitin 2010 romanin e saj të parë »Vajzat me çelës« <span> </span> i cili u vlerësua me çmimin KULT si libër i vitit 2011. Lindita Arapi ka studiuar për gjuhë-letërsi (1990–1994 ) në Universitetin e Tiranës. Përmbledhjen e parë me poezi e botoi në vitin 1993. Më 1996 u vendos në Gjermani ku studjoi për gjermanistikë në Universitetin e Köln-it. Ajo ka përkthyer gjithashtu tekste të ndryshme letrare nga gjermanishtja në shqip, ndër to poezi të Günter Grass, Joseph Roth, Elias Canetti dhe Felicitas Hoppe. Si gazetare është përgjegjëse për programin shqiptar të Deutsche Welle. Jeton në Bonn me familjen e saj. <b>ARIAN LEKA</b> (Shqipëri) Arian Leka lindi në vitin 1966 në Durrës, ku dhe ndoqi shkollën e muzikës për flautist. Pas kësaj ai ka studiuar për gjuhë dhe letërsi në Tiranë, si dhe për letërsi të re europiane në Firence. Arian Leka ka botuar disa përmbledhje poezish, tregimesh dhe një roman. Gjithashtu përkthen nga italishtja. Leka drejton shtëpinë botuese »Ideart«, është iniciator dhe drejtues i festivalit të letërsisë POETIKA në Durrës, si dhe kryeredaktor i një reviste letrare me po të njëjtin emër. Arian Leka është vlerësuar me çmimin kombëtar të poezisë »Lasgush Poradeci« <span> </span> 2011. <b>LULJETA LLESHANAKU</b> ( Shqipëri) Luljeta Lleshanaku konsiderohet si një nga zërat kryesorë të letërsisë bashkëkohore shqiptare. Lindi në vitin 1958 në Elbasan. Në kohën e diktaturës komuniste, familja e saj ka qenë e përndjekur nga regjimi dhe objekt i vazhdueshëm represioni. Pas rënies së regjimit komunist, Lleshanaku studjoi për gjuhë-letërs në Universitetin e Tiranës, më pas Creative Writing në Warren Wilson College në SHBA. Lleshanaku është vlerësuar me një sërë çmimesh ndërkombëtare si National Silver Pen Prize në vitin 2000 dhe Vilenice Kristal Prize më 2009. <b>FATOS LUBONJA</b> (Shqipëri) Universitetin e Tiranës. Gjatë regjimit komunist, u akuzua dhe arrestua për shkrimet që iu gjetën të fshehura, për agjitacion dhe propagandë kundër regjimit dhe për to u dënua me 7 vite burgim. U dënua sërish edhe 16 vite të tjera, me akuzën si pjesëtar i një organizate kundër-revolucionare. U lirua në vitin 1991, pas shtatëmbëdhjetë vitesh burgim. Përvojën e asaj kohe Lubonja e ka përmbledhur në romane autobiografike e tregime. Sot Lubonja është një nga publicistët e pavarur shqiptarë me shumë influencë, i cili angazhohet për të drejtat e njeriut, demokracinë dhe barazinë sociale në Shqipëri. Boton revistën publicistike »Përpjekja«.
	<b>Ceremonia e hapjes</b> <p>në sallën e Teatrit Kombëtare të Komedisë.</p> <p><i>Fjala përshëndetëse nga Ministria e Kulturës, znj. Mirela Kumbaro Furxhi</i></p> <p>dhe kuratores së projektit Prof. Christina Weiss.</p> <p>18.00</p>	
	<b>Fjalimi kryesor</b> <p>Fatos Lubonja</p>	
	<b>Diskutim ne panel »Europa si hapësirë e kujtesës«</b> <p>me autorët Lindita Arapi (Shqipëri ǄGjermani), Arian Leka (Shqipëri), Luljeta Lleshanaku (Shqipëri), Fatos Lubonja (Shqipëri), Khaled al Khamissi (Egjipt), Ilma Rakusa (Zvicër), Hans-Ulrich Treichel (Gjermani), Agron Tufa (Shqipëri)</p> <p>Moderatore: Dhurata Shehri</p> <p>19.00</p>	
	<span>☼</span>	
	<b>E SHTUNË Ǆ 5. TETOR 2013</b>	
	<b>Lexime të autorëve dhe diskutime</b>	
	<b>Khaled Al Khamissi &amp; Fatos Lubonja</b> <p>Moderatore: Mimoza Hysa</p> <p>10.30</p> <p><b>Lindita Arapi &amp; Arian Leka</b></p> <p>Moderatore: Mimoza Hysa</p> <p>12.00</p> <p><b>Pushim</b></p> <p>13.00–17.00</p>	
	<b>Luljeta Lleshanaku &amp; Ilma Rakusa</b> <p>Moderatore: Parid Teferiçi</p> <p>17.30</p> <p><b>Hans-Ulrich Treichel &amp; Agron Tufa</b></p> <p>Moderatore: Parid Teferiçi</p> <p>19.00</p>	

LETËRSITË PËRRETH MESDHEUT

Nën moton »Europa si hapësirë kujtese«, në datat 4. dhe 5. Tetor 2013, poetë, shkrimtarë dhe publicistë nga Shqipëria, Gjermania, Zvicra, Egjipti etj. ftohen të diskutojnë me njëritjetrin mbi gjëra që i bashkojnë dhe i ndajnë në trashëgiminë e përbashkët transnacionale.

Festivali letrar »Deti i Bardhë« vjen si një projekt i Allianz Kulturstiftung në bashkëpunim me Literarischen Colloquium Berlin dhe mbështetet nga Ministria e Kulturës së Shqipërisë. Në qendër të diskutimeve dhe leximeve që do të mbahen në kuadër të këtij aktiviteti qëndron hapësira e pangatërrueshme kulturore e vendeve të Mesdheut, me historinë e gjatë dhe të tashmen e mburjtur nga mospërputhjet. Deti Mesdhe na prezantohet në këtë festival ndërkombëtar letrar si një element ndërlidhës midis Europës, Afrikës së Veriut dhe Lindjes së Afërme, pra, si një hapësirë sa politike, aq edhe poetike.

Vështrimi drejt Detit Mesdhe nënkuptonte për shumë shqiptarë shpresë për lirinë, e cila u ishte mohuar për një kohë të gjatë. Tipari afrues i detit dhe aftësia e tij për të bashkuar njerëz, ide dhe të mira materiale, u kthye gjatë diktaturës 40 vjeçare të E. Hoxhës në simbolikë frike dhe mjet kontrolli mbi popullin. Edhe pse kufijtë mes popujve, sidomos në Europë kanë ndryshuar qindra herë, duke ngritur mure e barriera, deti nuk ndryshoi. Ai mbeti një vend i shpresës dhe i mallit.

Prandaj ky aktivitet letrar do të fokusohet veçanërisht në trajtimin e kujtesës historike në letërsi: në ç’mënyrë janë përpunuar përvojat totalitare dhe si e kanë gjetur ato rrugën për t’u futur në kujtesën letrare në secilin nga këto vende.

LETËRSITË PËRRETH MESDHEUT

**KHALED AL-KHAMISSI** (Egjipt) Khaled Al-Khamissi lindi në vitin 1962 në Kairo. Studjoi shkenca politike në Universitetin e Kairos dhe në Sorbonne, Paris. Al-Khamissi shkruan për disa gazeta egjiptiane, ku bie në sy si vëzhgues kritik i realitetit shoqëror. Gjithashtu ka qënë producent, regjisor dhe skenarist i filmave të ndryshëm. Botimi i fundit: »Arche Noah«. Përkthyer nga arabishtja nga Leila Chammaa (Lenos Verlag, Basel 2013) Botimi i fundit: »Arche Noah«. Përkthyer nga arabishtja nga Leila Chammaa (Lenos Verlag, Basel 2013) **ILMA RAKUSA** (Sllovaki) Ilma Rakusa lindi më 2 janar në Rimavská Sobota, Sllovaki. U rrit në Budapest, Ljubljana, Trieste e u vendos në Zyrih në vitin 1951. Studjoi sllavistikë dhe romanistikë në Zyrih, Paris dhe Shën Petersburg. Më 1971 promovoi me një punim që kishte si temë vetminë në letërsinë ruse. Prej vitit 1977 është lektore e Institutit Sllav të Universitetit të Zyrihut. Përveç kësaj punon si shkrimtare, përkthyese dhe publiciste në gazetat: »Neue Zürcher Zeitung«, »Die Zeit«. Botimi i fundit: »Mehr Meer. Erinnerungspassagen«. Droschl, Graz 2009 **HANS-ULRICH TREICHEL** (Gjermani) Hans-Ulrich Treichel, lindur më 1952 në Vermold|Westfalen, jeton në Berlin dhe Lajpzig. Ka studiuar në degën e gjermanistikës pranë Universitetit të Berlinit (Freie Universität Berlin) ku edhe ka promovuar më 1984. Prej vitit 1995 është profesor në Institutin Gjerman të Letërsisë në Universitetin e Lajpzigut. Romani »I humburi« flet për historinë një familjeje që në pamje të parë nuk ka asgjë të veçantë: Pas arratisë nga zonat lindore në vitin e fundit të luftës, fillon rimëkëmbja në kohën e mrekullisë ekonomike. Por për ta ka rëndësi vetëm një gjë: gjetja e djalit të madh që humbi gjatë arratisë, Arnoldit. Botuar në shqip: »I humburi« (Der Verlorene). Përkthyer nga Ardian Klosi. Shtëpia botuese K&B, Tiranë, 2009 **AGRON TUFA** (Shqipëri) Agron Tufa, lindur në vitin 1967 në Dibër, ka ndjekur studimet e larta për gjuhë dhe letërsi në Universitetin e Tiranës dhe më vonë në Institutin Gorki në Moskë. Në Institutin për Kulturën Europiane ai do të promovonte me një studim për filozofinë e përkthimit letrar »Mistika e origjinalit«. Prej 2001 është profesor i letërsisë së huaj të shekullit XX në Universitetin e Tiranës. Është poet (poezi të përkthyera nga Joachim Röhm dhe Hans Joachim Lanksch), prozator, eseist dhe kritik. Agron Tufa është vlerësuar me çmimin e madh kombëtar të letërsisë Shkrimtari i Vitit 2009. Jeton me familjen në Tiranë. Botimi i fundit: Fragmentet e gjësë, poezi, Shtëpia botuese OM, Prishtinë, 2013.